




UNIVERSITETI  
ZYBAKIMI  
NR. 332  
DATA 22.01.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORE**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR**

Nr. 61 Prot.

Vlorë më, 23.01.2025

**VENDIM**

Nr. 04, datë 23.01.2025

**PËR**

**PRANIMIN E ANKIMIT TË KANDIDATIT PROF.DR. KRISTOFOR LAPA PËR PAVLESHMËRINË E ZGJEDHJEVE PËR KOMISIONIN E DHËNIES SË GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” DHE DREJTUES TË DEPARTAMENTIT TË SHKENCAVE DETARE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI” VLORE**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”, miratuar me Vendimin nr. 11 të Senatit Akademik, datë 21.3.2024, Komisionit Institucional Zgjedhor, pas administrimit të shkresës me nr 58 prot, datë 22.01.2025, në mbledhjen e datës 23.01.2025.

**VENDOSI:**

1. Në mbështetje të nenit 38 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”, të pranojë ankesën e kandidatit Prof. Dr. Kristofor Lapa në lidhje me pavlefshmërinë e rezultateve të zgjedhjeve për Komisionin e Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” dhe të zgjedhjeve për Drejtues të Departamentit të Shkencave Detare në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, pasi në mënyrë të gabuar në secilën prej fletëve të votimit përpara emrit të ankuesit është reflektuar titulli shkencor Prof.Asoc. në vend të titullit më të lartë shkencor Prof. Dr., sikundër rezultojnë nga korrespondenca zyrtare e strukturave zgjedhore me Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore përmes shkresës nr 3051/1 prot, datë 24.12.2024. Në kushtet kur kandidati Prof. Dr. Kristofor Lapa është personel akademik me titullin shkencor më të lartë në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, pasaktësia e titullit shkencor e pasqyruar në fletën e votimit, çënon procesin zgjedhor.
2. Komisioni Institucional Zgjedhor në mbështetje të nenit 40, pika a të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”, shpall të pavlefshme zgjedhjet për Komisionin e Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” dhe zgjedhjet për Drejtues të Departamentit të Shkencave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR**

Detare në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë.

3. Vendimi i njoftohet kandidatit Prof. Dr. Kristofor Lapa.
4. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR**  
**OLJANA HOXHAI**

**ANËTARËT**

**LORENA ÇAKËRRI**

**ELDA LAMÇE**

**SONILA QIRKO**

**BIANKA KANANAJ**

